



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 143/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa Anr.143/2013 e datës 03.10.2013 e Lëvizjes Vetëvendosje, dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës Anr.143 datë 03.10.2013, LVV me të cilën pala ankuese kërkon që mos të shqyrtohet ankesa e lartcekur, me arsyetimin se Nisma Qytetare për Ferizaj (NQF) ka kërkuar ndjesë nëse është kryer një akt i tillë nga anëtarët e saj. Po ashtu, në bazë të kërkesës së LVV pohohet se e kanë kuptuar që NQF nuk ka pasur pretendime të këqija kundër LVV andaj edhe është kërkuar që të tërhiqet kjo ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 143/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LVP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 143/2013 më datën 05.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

